



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA E APELIT PRISHTINË

Numri i lëndës: 2024:121307
Datë: 29.07.2024
Numri i dokumentit: 05992308

PA1.nr.890/2024

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS - Departamenti i Përgjithshëm, në kolegjin penal të përbërë nga gjyqtarët Ferit Osmani , kryetar i kolegjit, Mehmet Ndrecaj, dhe Zyhdi Haziri anëtarë të kolegjit, me procesmbajtësen-praktikante Fitore Zeka , në çështjen penale kundër të akuzuarit A.B nga fshati-Komuna Obiliq, për shkak të veprës penale kanosje nga neni 181 par. 3 lidhur me paragrafin 2 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, duke vendosur sipas ankesës së mbrojtësit të të akuzuarit A.B , av. B.SH , të paraqitur kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Fushë Kosovë , Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.316/2024, datë: 17.05.2024, në seancën e kolegjit të mbajtur me datë **23.07.2024**, mori këtë:

A K T G J Y K I M

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të të akuzuarit A.B , av. B.SH , ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë-Dega në Fushë Kosovë , Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.316/2024, datë 17.05.2024, **VËRTETOHET**.

A r s y e t i m

GjykataThemelore në Prishtinë-Dega Fushë Kosovë , Departamenti i Përgjithshëm, P.nr.316/2024, datë 17.05.2024, të akuzuarin A.B , e ka shpallur fajtor për veprën penale kanosje nga neni 181 par. 3 lidhur me paragrafin 2 lidhur me nenin 77 të KPRK-së, dhe i ka shqiptuar dënim me burgim në kohëzgjatje prej një viti , i cili dënim nuk do të ekzekutohet në periudhë të verifikimit prej 2 vitesh nga plotfuqishmëria e këtij aktgjykimi , në qoftë se gjatë kësaj kohe nuk do të kryej veprë penale .

Nëse i pandehuri kryen vepër tjetër penale gjatë kohës së verifikimit , atëherë dënimi me burgim me kushtë ka për t'iu revokuar në dënim me burg, ku do të llogaritet koha e kaluar në masë të paraburgimit nga data 23.04.2024 deri më 17.05.2024. Detyrohet i akuzuari që në emër të shpenzimeve të procedurës penale, për paushallin gjyqësor të paguaj shumën prej 20.00€ (njëzet/euro), gjithashtu në emër të taksës për kompensimin e viktimave të paguaj shumën prej 20.00€ (njëzet/euro), në afat prej 15 ditësh pasi aktgjykimi të merr formën e prerë. Të dëmtuarit – zyrtar policor G.H , K.P , F.C dhe SH.G , udhëzohen që kërkesën pasurore juridike mund ta realizojnë në kontest civil. Me aktvendim të veçantë të datës 17.05.2024 të pandehurit A.B , gjykata ia ndërprente masën e paraburgimit , ashtu që i njëjti lëshohet menjëherë në liri.

Kundër këtij aktgjykimi në afatin ligjor ankesë ka paraqitur :

Mbrojtësi i të akzuarit A.B , av. B.SH , për shkak të vendimit lidhur me sanksionin penal, duke i propozuar kolegjit penal të Gjykatës së Apelit që ta aprovojë ankesën dhe ta ndryshojë aktgjykimin e atakuar, dhe të pandehurit ti shqiptohet një dënim më i butë .

Prokurori i Prokurorisë së Apelit, me parashtrësën me shkrim PPA/II.nr.891/2024, të dt. 07.06.2024 ka propozuar që të refuzohet si e pabazuar ankesa e mbrojtësit të të akzuarit ndërsa aktgjykimi të vërtetohet.

Kolegji penal i Gjykatës së Apelit të Kosovës, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës, vlerësoj pretendimet ankimore dhe analizoj aktgjykimin e ankimuar në kuptim të nenit 394 paragrafi 1 të KPPRK-së, konstatoj se:

- ankesa nuk është e bazuar.

Edhe pse aktgjykimi i gjykatës së shkallës së parë nuk është ankimuar për shkak të shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës penale, megjithatë kolegji penal i Gjykatës së Apelit, duke u bazuar në nenin 394 par. 1 të KPPRK-së, sipas detyrës zyrtare, e shqyrtoj aktgjykimin e ankimuar edhe në këtë drejtim, dhe konstatoj se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale, kjo për faktin se aktgjykimi i ankimuar është përpiluar në harmoni të plotë me dispozitat ligjore nga neni 369 i KPPRK-së, dispozitivi i aktgjyimit të ankimuar është i qartë, në dispozitivin e këtij aktgjykimi janë përshkruar qartë të gjitha veprimet inkriminuese të të akzuarit, në të cilat veprime manifestohen të gjitha elementet qenësore të kësaj vepre penale, për të cilën është akuzuar dhe shpallur fajtor i akuzuari. Po ashtu dispozitivi i aktgjyimit të ankimuar nuk është në kundërshtim me vetveten e as me arsyetimin e të njëjtit, në arsyetimin e aktgjyimit të ankimuar, gjykata e shkallës së parë ka paraqitur në mënyrë mjaftë të plotë dhe të qartë të gjitha arsyet përkitazi me faktet vendimtare me rastin e vendosjes në këtë çështje penale.

Po ashtu as gjendja faktike nuk ka qenë objekt vlerësimi i kësaj gjykate, ngase as me ankesë nuk ka mund të kontestohet, për faktin se i akuzuari në shqyrtimin fillestar e ka pranuar fajësinë, dhe gjyqtari i vetëm gjykues e ka aprovuar një pohim të tillë, dhe bazuar në nenin 383 par.2 të KPPRK-së, aktgjykimin e ankimuar e vlerësoj vetëm në bazë të pretendimeve në ankesë të parashtruara nga mbrojtja e të akuzuarit.

Po ashtu aktgjykimi i ankimuar nuk është goditur as për shkak të shkelje të Ligjit Penal, megjithatë kolegji penal i Gjykatës së Apelit, duke u bazuar në nenin 394 par. 1 të KPPRK-së, e shqyrtoj aktgjykimin e ankimuar edhe sipas detyrës zyrtare për shkelje të Ligjit Penal në dëm të të akuzuarit, dhe konstatoj se aktgjykimi i ankimuar nuk është i përfshirë as me shkelje të Ligjit Penal në dëm të të akuzuarit, në radhë të parë për faktin se nga pranimi i fajësisë nga i akuzuari dhe aprovimi i këtyre deklaratave nga Gjykata e shkallës së parë, është vërtetuar gjendja faktike e përshkruar si në dispozitivin e aktgjykimit të ankimuar, dhe me këtë rezulton se është vërtetuar se në veprimet e të akuzuarit janë manifestuar elementet qenësore të kësaj vepre penale për të cilën është shpallur fajtor dhe gjykuar i akuzuari, si dhe për faktin se kjo vepër për të cilën është gjykuar i akuzuari është vepër penale, nuk ekzistojnë rrethana që e përjashtojnë përgjegjësinë penale të të akuzuarit, dhe ndjekjen penale për këto vepra penale, dhe as zbatim të gabuar të Kodit Penal.

Sipas vlerësimit të kolegjit penal të Gjykatës së Apelit, pretendimet ankimore të paraqitura në ankesën e mbrojtësit të të akuzuarit, që të akuzuarit ti zbutë dënimin janë të pabazuara, kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë i ka vlerësuar dhe konstatuar drejtë të gjitha rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ku si rrethanë lehtësuese për të akuzuarin Alush Bërbatovci ka marrë faktin se i akuzuari në shqyrtimin fillestar e ka pranuar në tërësi fajësinë për veprën penale e cila e vihet në barrë, pendimin dhe premtimin se në të ardhmen nuk do të përsëritet, pranon gabimin e bërë për shkak të ngarkesës fizike në punë, thotë se nuk e ka bërë me qëllim, as që i ka njohur policët dhe se nuk ka asgjë kundër tyre, andaj gjykata duke i vlerësuar këto rrethana ka ardhur në përfundim se dënimi i shqiptuar të akuzuarit si në dispozitiv të këtij aktgjykimi është në përputhje me peshën e veprës penale, shkallën e përgjegjësisë penale të tij, gjykata gjithashtu është e bindur se vendimi mbi dënim do të shërbej për arritjen e qëllimit të dënimit në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, por ai duhet të ndikoj edhe si preventivë e përgjithshme për personat tjerë që t'i parandaloj nga kryerja e këtyre veprave penale dhe të shpreh gjykim shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, të gjitha këto të parapara me nenin 38 të KPPRK-së. Gjykata e Apelit këtë konstatim të Gjykatës së shkallës së parë e vlerëson si të drejtë dhe në proporcion me dënimin e shqiptuar nga e njëjta. Kjo për faktin se gjykata e shkallës së parë në përgjithësi drejtë i ka konstatuar dhe vlerësuar rrethanat të cilat ndikojnë në caktimin e llojit dhe lartësisë së dënimit, ndërsa në ankesën e lartcekur nuk është paraqitur ndonjë rrethanë e rëndësishme dhe e posaçme që nuk është vlerësuar nga gjykata e shkallës së parë e cila do ta arsyetonte shqiptimin e një dënimi më të butë ose më të lartë ndaj të akuzuarit.

Andaj, duke i pasur parasysh të gjitha rrethanat të cilat i ka konstatuar dhe vlerësuar gjykata e shkallës së parë, të cilat rrethana i aprovon edhe kolegji penal i kësaj gjykate, edhe bazuar në rrethanat relevante ekzistuese në rastin konkret, dënimi i shqiptuar nga gjykata e shkallës së parë, është dënim i drejtë, i ligjshëm, në harmoni me peshën e veprës penale, me shkallën e rrezikshmërisë shoqërore të kësaj vepre penale të kryer dhe shkallën e përgjegjësisë penale të të akuzuarit, dhe se kolegji penal i kësaj gjykate, vlerëson se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit, e i cili konsiston në parandalimin e të akuzuarit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale, të bëjë kompensimin e viktimave ose të komunitetit për humbjet ose dëmet e shkaktuara nga vepra penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit, në kuptim të nenit 38 të KPRK-së.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart dhe në bazë të nenit 401 të KPPRK-së, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
Departamenti i Përgjithshëm
PA1.nr.890/2024, me datë 23.07.2024

Procesmbajtëse- Praktikante

Fitore Zeka

Kryetari i kolegjit

Ferit Osmani

Antarët e kolegjit:

Mehmet Ndrecaj

Zyhdi Haziri